

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shtatë emrat e UÇK-së në aktgjykimin e 16 shtatorit: a mund të ketë pasoja të reja juridike?
ADRESA	https://albeu.com/kosove/shtate-emrat-e-uck-se-ne-aktgjykimin-e-16-shtatorit-a-mund-te-kete-pasoja-te-reja-juridike/1016754/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 05:56:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 05:50:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0cedfdca6d156dd29ec5ef938a274e27e80fd7bf52e2f06c5dbe792537fec342
TEKSTI	f086aef44c6cdc277c639000b4a04db6e88b8bb241c9127fc72b3f3fcbce6169
PAMJA	cba021951b1911c437b197836c18b59f6e9630c2f5346c670230937e59b3986d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	309e9ee749a9b634a0b18793a69fafa9d7739eb776be81e121a13966ac2583d2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0c0dec12bc237ce7a3b53840342154b6dec8e6e0aa6a337693272add88847ea6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/309e9ee749a9b634a0b18793a69fafa9d7739eb776be81e121a13966ac2583d2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shtatë emrat e UÇK-së në aktgjykimin e 16 shtatorit: a mund të ketë pasoja të reja juridike?



Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Latif Gashi, Shukri Buja dhe Sabit Geci nuk kanë qenë të pandehur në procesin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Megjithatë, emrat e tyre u përfshinë në aktgjykimin e 16 shtatorit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.

Gjatë shpalljes së vendimit fajësues për krime lufte ndaj katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), trupi gjyqësor, i njohur edhe si Gjykata Speciale, tha se shtatë figurat e tjera kishin qenë pjesë e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale".

Sipas konstatimeve të gjykatës, Limaj, Geci, Mustafa dhe Gashi "ishin zbatues të zellshëm të qëllimit kriminal që kishte në shënjestër kundërshtarët".

Çfarë nënkuptoi Specialja me "ndërmarrjen e përbashkët kriminale"?

Trupi gjyqësor e arsyetoi ekzistencën e një "qëllimi të përbashkët kriminal" duke iu referuar disa elementeve, përfshirë vrasjet e shqiptarëve të dyshuar si bashkëpunëtorë dhe të serbëve, komunikatat politike, luftën speciale, qendrat e ndalimit, si dhe tolerimin, pranimin dhe nxitjen e krimeve ndaj kundërshtarëve.

Gjyqtarët vlerësuan se katër ish-komandantët e UÇK-së u kishin caktuar vetes dhe personave të tjerë role e funksione që u mundësuan të "kontrollonin zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal".

Vlerësime për "kriminalizim retrospektiv" të udhëheqjes së UÇK-së

Geoffrey Nice, ish-prokuror i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), e ka cilësuar si "të paprecedentë" mënyrën se si Brahimaj, Limaj, Sylejman Selimi, Mustafa, Gashi, Buja dhe Geci u përmendën në aktgjykimin ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së.

të fundit /



Përplasja me magistratët/ Rama paralajmëron ligj të ri...



Shtatë emrat e UÇK-së në aktgjykimin e 16 shtatorit: a mund të...



Avokatja e Jakup Krasniqit paralajmëron apel: Asnjë dëshmitar...



Revolta qytetare hyn në ditën e 111-të, protestuesit sot sërís...



El Niño dhe ngrohja globale/ Rekord avujsh uji në atmosferë, rrite...



Institucionet e drejtësisë e kundërshtuan,...



Kushte atmosferike të qëndrueshme/ Parashikimi i motit, 1...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë (REL), Nice shpjegon se në aktgjykime mund të thuhet se një person ka "vepruar në kuadër të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale me persona të panjohur".

Avokati i licencuar në Dhomat e Specializuara, Artan Qerkini, deklaroi për REL-in se trupi gjykses kishte nevojë të përfshinte edhe "anëtarë" të tjerë në këtë "qëllim të përbashkët", në mënyrë që katër të dënuarit të lidheshin me krimet e kryera nga persona të tjerë.

Nevenka Tromp, hulumtuese e TPNJ-së që ka përcjellë nga afër edhe procesin në rastin "Thaçi dhe të tjerët", tha se me këtë përfundim Gjykata Speciale e përshkroi të gjithë Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së si pjesëmarrës në një "ndërmarrje kriminale".

"Është një kriminalizim retrospektiv i strukturës qendrore komanduese të UÇK-së si tërësi, në një shkallë që aktgjykimet e vetë TPNJ-së nuk e vërtetuan kurrë", tha Tromp për REL-in.

A mund të hetojë Prokuroria Speciale ndaj shtatë personave?

Përmbledhja e aktgjykimit të 16 shtatorit thotë se shtatë figurat e UÇK-së ishin pajtuar me "qëllimin e përbashkët kriminal". Në të njëjtën kohë, dokumenti sqaron se ndaj tyre nuk është konstatuar fajësi dhe se ata vazhdojnë të gëzojnë prezumimin e pafajësisë.

Artan Qerkini theksoi se përmendja e emrave në aktgjykim nuk mund të konsiderohet kallëzim penal ndaj tyre.

"Zyra e Prokurorit të Specializuar i ka pasur këta emra në aktakuzën e vet që nga viti 2020, dhe për gjashtë vjet nuk ka ngritur aktakuzë ndaj tyre", tha ai.

Sa i përket mundësisë që shtatë të përmendurit të përballen me pasoja juridike, Qerkini tha se çështja e Sylejman Selimit është "e mbyllur përfundimisht", pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar i kishte ndërprerë hetimet ndaj tij në shkurt të vitit 2025.

Ai shtoi se edhe personat e tjerë janë përballur më herët me procese gjyqësore dhe se në këto raste zbatohet parimi i së drejtës penale "jo dy herë gjykim për të njëjtën çështje".

Prokuroria Speciale i tha REL-it javë më parë se nuk komenton për "ekzistencën ose hollësitë e ndonjë hetimi".

Sipas këtij institucioni, mandati i tij do të vazhdojë "derisa Këshilli i Bashkimit Evropian të njoftojë institucionet e Kosovës se hetimet dhe procedurat përkatëse kanë përfunduar".

Shukri Buja, i cili u përmend nga trupi gjykses më 16 shtator, nuk beson se ndaj tij mund të nisë ndjekje penale, pasi prokurorët e Speciales i mbyllën në vitin 2024 hetimet që kishin filluar pesë vjet më herët.

"Jam rasti i parë që i kanë mbyllur hetimet, dhe në njëfarë forme e kanë shpallur luftën time të drejtë dhe të panjollësor", tha Buja për REL-in.

Ai deklaroi se cilësimi "anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale" nuk e dëmton reputacionin e tij. Sipas Bujës, ndryshe ka ndodhur me aktgjykimin që "padrejtësisht" njolloosi katër ish-krerët e UÇK-së.

Cilat kanë qenë përvojat gjyqësore të shtatë figurave?

Disa prej shtatë personave të përmendur në aktgjykim janë marrë në pyetje nga Prokuroria e Specializuar në Hagë.

Përpara kësaj, ata kishin kaluar nëpër përvoja të ndryshme me sistemin e drejtësisë për çështje që lidhen me krimet e luftës.

Lahi Brahimaj dhe Fatmir Limaj janë gjykuar nga TPNJ-ja, por të dy u shpallën përfundimisht të pafajshëm. Limaj u shpall i pafajshëm edhe në rastet "Klečka" dhe "Bellanica" në Kosovë.

Sylejman Selimi, Rustem Mustafa dhe Latif Gashi janë dënuar nga gjykatat në Kosovë për krime lufte. Selimi më vonë u shpall i pafajshëm gjatë rigjykimit të njërit prej rasteve.

Sabit Geci është dënuar në Kosovë për krime lufte ndaj civilëve, ndërsa Shukri Buja nuk është përballur me ndonjë proces gjyqësor për krime lufte.

Ish-prokurori Nice tha se duhet pritur publikimi i aktgjykimit të plotë për të kuptuar nëse gjykata do të japë arsyetim lidhur me përfshirjen e këtyre shtatë emrave në çështjen kundër katërshes së UÇK-së. / REL



Avokatja e Jakup Krasniqit paralajmëron apel: Asnjë dëshmitar nuk raportoi...



Sot zhvillohet ceremonia mortore për Flora Brovinën



Protestë gjithëpopullore sot në mesditë në sheshin "Skënderbeu



Klestor Veseli: Sot i japim zë qëndrimit të popullit



Kurti çmon Visar Morinën dhe filmin "Shame and money



Robert Bosch: Vendimi për Thaçin është skandaloz, Specialja i shërbeu...



Endrit Thaçi në protestë: Besojmë në pafajësinë e çlirimtarëve, populli...



Këshilli i Ambasadorëve të Kosovës kundërshton aktgjykimin e Dhomave t...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Vellaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.